ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri i prokurimit	**214-23-13065-211**

Sa i përket tenderit për: Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së –Ri tender

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: "Beni Dona Plast: SH.P.K

Adresa : Lagja Ulpiana, Rruga Imzot Nikë Prelaj , Prishtine

Numri Telefonit: 038-500-894

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: Fadil Paçarada

Adresa elektronike: *prokurimi.zyra@gmail.com*

Data e parashtrimit të ankesës: 18.12.2023

Nënshkrimi dhe vula:_____

BENI DONA PLAST SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. **B05- Njoftim për kontrate: 24.11.2023**
2. **Afati për dorëzim të tenderit: 13.12.2023;**
3. **Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët**
4. **Aneksi 5- Kërkesë për Informacione shtese: 04.12.2023**
5. **Informacione shtesë të publikuara nga AK në platformën e e-Prokurimit me datën 07.12.2023;**
6. **Kërkesë për Ri-shqyrtim: 07.12.2023**
7. **Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim: 08.12.2023**
8. **Formulari B54- Njoftim për Informata Shtese ose Përmirësim i Gabimit- 11.12.2023**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**		

Nuk aplikohet - Hapja e ofertave është planifikuar të behet me datën 21.12.2023 në ora 14:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po					**Jo**		

Nuk Aplikohet pasi që Kërkua për Rishqyrtim ka të beje me Dokumentet e Tenderit – Faza para tenderimit.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 07.12.2023 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Me datën 08.12.2023 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën ton për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Shkeljet e dispozitave - Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, janë:

Neni 17 - Dosja e Tenderit
Neni 19 - Specifikimet Teknike
Neni 25 -Kriteret e përzgjedhjes

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (AK) – Akademia e Kosovës për Siguri Publike më datën **24.11.2023** në Platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Formularit – **B05 - Njoftim për Kontrate** për aktivitetin me numër të prokurimit - **214-23-13065-211 - Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së –Ri tender.**

Pasi kemi shkarkuar Dosjen e Tenderit, Njoftimin për Kontrate dhe Përshkrimin e Çmimeve, kemi vërejtur së AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike, gjate zhvillimit të aktivitetit të prokurimit të cekur me larte prape ka vazhduar me shkelje substanciale të legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Për ti dhen një mundësi AK, që ti beje korrigjimet nevojshme, ne me datën **04.12.2023** , përmes Platformës së E-Prokurimit, kemi plotësuar dhe dërguar të AK - Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Aneksin 5, të Dosjes së Tenderit – Kërkese për Informacione Shtese.

AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike deri me datën **07.12.2023** në ora **14:30**, në Platformën e E – Prokurimit nuk i ka publikuar përgjigjeje në kërkesën ton për informacione shtese.

AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike deri me datën **07.12.2023** në ora **14:53**, në Platformën e E – Prokurimit, ka publikuar përgjigjeje në kërkesën ton për informacione shtese.

Në këto sqarime shtese që ka publikuar në Platformën e E-Prokurimit, shihet së AK prape nuk ndërmori asnjë veprim për të larguar kriterin diskriminues që e ka kërkuar në Dosjen e Tenderit të Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), të neni 7.1 & 7.2 - Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale – dhe të Njoftimi për Kontrate , nenit III.2.2)- Përshtatshmëria profesionale, **8. Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr. 3,4,5,6.**
Dëshmia e kërkuar dokumentare: **8. Autorizimi nga prodhuesi për shitjen apo dileri i autorizuar për shitjen e ushqimit të paketuar me nr. 3,4,5,6.,(origjinal ose koje e noterizuar).**

Gjithashtu AK, sipas këtyre sqarime dëshmoj së nuk do ta beje asnjë ndryshim në Dosjen e Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve sa i përket rregullimit të artikujve sipas shujtave - menyve dhe largimit të artikujve - **ushqimit të paketuar me nr. 3,4,5,6** , të cilët i ka shënuar në Përshkrimin e Çmimeve vetëm sa për të ju pa mundësuar OE ofertimin në ketë aktivitet të prokurimit dhe favorizuar vetëm një OE të preferuar nga AK i cili mbi 10 vite radhazi ka kontrate me AK.

AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike asnjë here deri me tani në Specifikacionin Teknik dhe Përshkrimin e Çmimeve nuk kane pasur të shënuar – **ushqimi i paketuar siç janë tani artikuj me nr. 3,4,5,6.**

Pasi që afati për hapje të ofertave ishte shume i shkurte, data **13.12.2023** , me qellim që me ju dhëne edhe një mundësi AK që ti bëjnë korrigjimet e nevojshme duke i hequr kriteret diskriminuese, rregullimin e Aneksit 1, të Dosjes se Tenderit dhe rregullimin e Përshkrimit të Çmimeve sipas shujtave- menyve , në shfrytëzuam të drejtën tone ligjore dhe me datën **07.12.2023** dërguam të AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike - Kërkesën për Rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues, më datën **08.12.2023** në Platformën e E-Prokurimit ka publikuar, Vendimin për refuzimin e Kërkesës tone për Rishqyrtim si të pa bazuar.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues me datën **11.12.2023**, në Platformën e E-Prokurimit ka publikuar Formularin B54- Njoftim për Informata Shtese ose Përmirësim i Gabimit, ku ka bere vetëm shtyrjen e afatit të pranimit të ofertave për datën **21.12.2023** ora **14:00**, ndërsa nuk ka bere asnjë ndryshim tjetër.

Pretendimet tona ankimore janë:

Pretendimi 1:

Në Dosjen e Tenderit të Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), të neni 7.1 & 7.2 - Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale – dhe të Njoftimi për Kontrate , nenit III.2.2)- Përshtatshmëria profesionale, AK ka kërkuar:

8. Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr. 3,4,5,6.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: **8. Autorizimi nga prodhuesi për shitjen apo dileri i autorizuar për shitjen e ushqimit të paketuar me nr. 3,4,5,6.,(origjinal ose koje e noterizuar).**

Kërkesa për Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr. 3,4,5,6, është diskriminuese dhe në kundërshtim të plote me **nenin 7 të LPP - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, nenin 51 të LPP- Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes dhe nenin 25 të Rregullores 01/2022 - Kriteret e përzgjedhjes.**

Kjo kërkesë është diskriminuese për faktin së nuk **është drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën - aktivitetin e prokurimit të cilin AK është duke e zhvilluar**. AK ka vendose ketë kërkesë për ta favorizuar OE të preferuar nga ana e AK , të cilin e ka shpërblyer me kontrate për mbi dhjete vite me radhe. AK që një vit qëllimisht e dështon aktivitetin e prokurimit dhe pastaj zhvillon aktivitet tjetër të prokurimit duke shfrytëzuar Procedurën e Negociuar pa Publikimin të Njoftimit për Kontrate dhe në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik, fton për negociata vetëm OE të preferuar dhe ja vazhdon

kontratën më çmime mbi **30 %** me te larta së të ofertueseve tjerë që kane ofertuar në aktivitetin e prokurimit që AK qëllimisht e ka dështuar.

Ne si kompani kemi ofertuar në qindra aktivitete të prokurimit të natyrës së njëjte me aktivitetin që AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike, është duke e zhvilluar, por asnjëherë për mbi 20 vite nuk ka ndodhur që ndonjë nga AK në Kosove të ketë kërkuar Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për artikuj ushqimor. Një kërkesë të tille kaq diskriminuese nuk e ka pasur deri me tani as vete AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike. Por si duket në pa mundësi që përmes procedurës së hapur dhe jo diskriminuese ta shpërblej me kontrate OE të preferuar me çmime shume me të larta së të tregut, ka vendosur në Përshkrimin e Artikujve , katër artikuj të cilët asnjëherë nuk janë tregtuar në tregun e Kosovës e të cilët nuk prodhohen e tregtohen as në regjionin e Ballkanit e me shume vështirësi gjinden në tregun e Evropian dhe pikërisht për këta katër artikuj ka kërkuar Autorizim për shitjen e tyre.

Pretendimi 2:

AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Dosjen e Tenderit – Aneksin nr. 1- Specifikimet Teknike të Detyrueshme dhe Përshkrimin e Çmimeve- Specifikacioni për Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimin me ushqim për nevojat e AKSP-se, e ka hartuar në kundërshtim të plote të LPP - nenin 27 të LPP - Dosja e Tenderit, nenin 28 të LPP- Specifikimet teknike , nenin 17 te Rregullores 01/2022 - Dosja e Tenderit dhe nenin 19 Rregullores 01/2022 - Specifikimet Teknike.

Pse në konsiderojmë kështu:

Pjesa A- Mëngjesi – për të gjithë artikujt prej nr. **1** deri nr. **21,** AK ka kërkuar sasinë prej **12145 cope.**

Për artikullin me **nr.1 – Bukë 150 gr**. AK ka kërkuar sasinë vetëm **12145** cope, e në anën tjetër për të gjithë artikujt tjerë që përbejnë së paku **10** lloje të racioneve (menyve) të mëngjesit, për çdo njërin prej tyre ka kërkuar sasinë prej **12145 cope.** Sipas kësaj që ka shënuar AK, del që çdo person për çdo racion të mëngjesit i konsumon të gjithë **21** artikujt që janë të shënuar në Aneksin 1 të DT dhe Përshkrimin e Çmimeve, çka nuk është e vërtete së konsumohen.

Pjesa B- Dreka – për të gjithë artikujt prej nr. **1** deri nr. **26** , AK ka kërkuar sasinë prej **16890 cope.**

Për artikullin me **nr.1 – Bukë 200 gr,** që konsumohet me çdo racion të drekës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **16890 cope,**

Për artikullin me **nr.2 – Supe 200 gr,** që konsumohet me çdo racion të drekës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **16890 cope,**

Për artikullin me **nr.3 – Sallate 200 gr,** që konsumohet me çdo racion të drekës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **16890 cope,**

Për artikullin me **nr. 4 – Desert 80 gr,** që konsumohet me çdo racion të drekës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **16890 cope,**

Për artikullin me **nr. 5 – Peme,** që konsumohet me çdo racion të drekës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **16890 cope,**

Për artikullin me **nr. 6 – Pije të gazuara 330.ml** që konsumohet me çdo racion të drekës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **16890 cope,**

Gjithashtu për të gjithë artikujt tjerë që përbejnë **20 lloje** të racioneve (menyve), të drekës, për çdo njërin prej tyre ka kërkuar sasinë prej **16890 cope** . Sipas kësaj që AK ka kërkuar , del që çdo person për çdo racion të drekës i konsumon të gjithë **26** artikujt që janë të shënuar në Aneksin 1 të DT dhe Përshkrimin e Çmimeve, çka nuk është e vërtete së konsumohen.

Për informimin tuaj:

OE i preferuar nga AK që është duke realizuar kontratat për mbi 10 vite, në aktivitetin e fundit të prokurimit (që AK qëllimisht e ka dështuar) , ka ofertuar me këto çmime:

Artikulli - 1 – Bukë 200 gr	= 0.40
Artikulli - 2 – Supe 200 gr	=1.00
Artikulli - 3 – Sallate 200 gr	=1.50
Artikulli - 4 – Desert 80 gr	=1.00
Artikulli - 5 – Peme	=0.30
Artikulli - 6 – Pije të gazuara 330.ml	=0.90
Totali prej 1 deri 6:	= 5.10 €

Këta gjashte artikuj konsumohen në çdo racion të drekës, ndërsa të **20 artikujt** tjerë konsumohen sipas menyve që AK i kërkon gjate realizimit të kontratës që zakonisht vetëm tre deri në pese prej tyre konsumohen brenda një dite.

Vetëm **këta gjashte artikuj** pa përfshirë menynë - ushqimin kryesor, kane koston prej 5.10 €. Kur kësaj i shtohet çmimi i menysë - ushqimin kryesor që OE ka ofertuar, mesatarisht 2.60 €, del së një racion i drekës ka koston totale prej **7.60 €.**

Një çmim kaq të larte e manipulues të menysë se drekës nuk e ka të kontraktuar asnjë nga Autoritetet Kontraktuese në Republikën e Kosovës. Ketë mënyre të manipulimit të çmimeve ja ka mundësuar vete AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike ,duke hartuar Përshkrimin e Artikujve – Listën e Çmimeve më sasi të njëjta për të gjitha artikujt si ne rastin konkret në aktivitetin që është duke e zhvilluar tani. AK ka kërkuar sasinë e njëjte 16890 cope për të gjashte artikujt veç e veç që konsumohen për çdo racion të drekës dhe ne anën tjetër kërkon sasinë e njëjte 16890 për çdo artikull të menysë kryesore që maksimalisht vetëm tre deri në pese prej tyre konsumohen si racione të drekës brenda një dite.

Pjesa C- Darka – për të gjithë artikujt prej nr. **1** deri nr. **20** , AK ka kërkuar sasinë prej **12145 cope.**

Për artikullin me **nr.1 – Bukë 200 gr,** që konsumohet me çdo racion të darkës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **12145 cope,**

Për artikullin me **nr.2 – Sallate 200 gr,** që konsumohet me çdo racion të darkës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **12145 cope,**

Për artikullin me **nr. 3 – Lëngje frutash 250 ml,** që konsumohet me çdo racion të darkës AK, ka kërkuar sasinë vetëm **12145 cope,**

Gjithashtu për të gjithë artikujt tjerë që përbejnë **17 lloje** të racioneve (menyve), të darkës, për çdo njërin prej tyre ka kërkuar sasinë prej **12145 cope** . Sipas kësaj që AK ka kërkuar , del që çdo person për çdo racion të darkës i konsumon të gjithë **20** artikujt që janë të shënuar në Aneksin 1 të DT dhe Përshkrimin e Çmimeve, çka nuk është e vërtete së konsumohen.

Për informimin tuaj:

OE i preferuar nga AK që është duke realizuar kontratat për mbi 10 vite, në aktivitetin e fundit të prokurimit (që AK qëllimisht e ka dështuar) , ka ofertuar me këto çmime:

Artikulli - 1 – Bukë 200 gr	= 0.40
Artikulli - 2 – Sallate 200 gr	=1.50
Artikulli - 3 – Lëngje frutash 250 ml	=0.90
Totali prej 1 deri 3:	= 2.80 €

Këta tre artikuj konsumohen në çdo racion të darkës, ndërsa të **17 artikujt** tjerë konsumohen sipas menyve që AK i kërkon gjatë realizimit të kontratës që zakonisht mund të jene vetëm tre deri në pese prej tyre brenda një darke.

Vetëm **këta tre artikuj** pa përfshirë menynë - ushqimin kryesor, kane koston prej 2.80 €. Kur kësaj i shtohet çmimi i menysë - ushqimin kryesor që OE ka ofertuar, mesatarisht 2.70 €, del së një racion i darkës ka koston totale prej **5.50 €.**

Një çmim kaq të larte e manipulues të menysë së darkës nuk e ka të kontraktuar asnjë nga Autoritetet Kontraktuese në Republikën e Kosovës. Ketë mënyre të manipulimit të çmimeve ja ka mundësuar vete AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike,duke hartuar Përshkrimin e Artikujve – Listën e Çmimeve më sasi të njëjta për të gjitha artikujt si në rastin konkret në aktivitetin që është duke e zhvilluar tani. AK ka kërkuar sasinë e njëjte 12145 cope për të tre artikujt veç e veç që konsumohen për çdo racion të darkës dhe në anën tjetër kërkon sasinë e njëjte 12145 për çdo artikull të menysë kryesore që maksimalisht tre deri në pese prej tyre konsumohen si racione të darkës.

Nëse Aneksi Nr. 1 i Dosjes së Tenderit dhe Lista e artikujve - Përshkrimi i Çmimeve për mëngjesin, dreken dhe darken mbesin ashtu siç i ka shënuar AK, lëne mundësin e manipulimit të çmimeve gjate fazës së ofertimit dhe llojeve dhe sasive të artikujve gjate fazës së realizimit të kontratës, ku në rast të shpërblimit me kontrate të OE të preferuar nga AK, do të porositen vetëm artikuj me çmimet me të larta ashtu siç është duke vepruar AK për mbi 10 vite me kontratat që ka të nënshkruar dhe realizuar me OE të preferuar.

Pse ne konsiderojmë së AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike ne Aneksi Nr. 1 i Dosjes së Tenderit dhe Lista e artikujve - Përshkrimi i Çmimeve ka vendose sasinë e artikujve në mënyre spekuluese e dëshmon edhe fakti së në faqen 25 të Dosjes se Tenderit të Aneksi nr. 1- Specifikimet Teknike te detyrueshme ka shënuar këto të dhëna manipuluese:

- Sasia e përafërt e zgjedhjeve për mëngjes **255045** për 36 muaj
- Sasia e përafërt e zgjedhjeve për dreka **439140** për 36 muaj
- Sasia e përafërt e zgjedhjeve për darkë **242900** për 36 muaj
- Sasia e përafërt për dreka zyrtare **800** për 36 muaj
- Sasia e përafërt për ushqim të paketuar 100800 zgjedhje për gjithsejtë **16800** pako nga të gjitha llojet: (1+2+3+4+5+6) për 36 muaj
- Sasia e përafërt për koktej **1600** për 36 muaj
- Sasia e përafërt e pijeve **111559** për 36 muaj
- Sasia e përafërt e kësaj vlere për 36 muaj mund te ndryshoj +/- 30 %

Kur këto sasi të artikujve të cilat i ka shënuar AK i shumëzojmë më çmimet me të cilat ka ofertuar OE i preferuar nga AK, del se vlera e parashikuar për 36 muaj vetëm për mëngjes, dreke dhe darke duhet të jete: **5,311,026.50 €**

Mëngjes- sasia:	255 045	copë X 2.50 =	637,612.50
Dreka-sasia:	439 140	copë X 7.60 =	3,337,464.00
Darka- sasia:	242 900	copë X 5.50 =	1,335,950.00
Totali i vlerës:			**5,311,026.50**

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate ka shënuar vlerën e parashikuar: **1.608.300,00 €**

Këto të dhëna me se miri e dëshmojnë se sa jo profesionale dhe spekuluese është përgatitur Dosja e Tenderit dhe Lista e artikujve – Përshkrimi i Çmimeve.

Pjesa G- Ushqim i Paketuar 3 – Në Aneksin nr. 1 të DT të artikulli në nr. 2, AK ka kërkuar: **Pashtet pule 120gr** , ndërsa të përshkrimi i artikujve ka kërkuar që pashteta të jete në ketë përbërje: **Mëlçi e gjelit të detit (20%) mish pulës (20%), rrënjë, perimesh, karrot, selino, majdanoz, ujë, qep (5%), hudhër, krip, gjethe dafine.**

Pjesa H- Ushqim i Paketuar 4 - Në Aneksin nr. 1 të DT të artikulli në nr. 2, AK ka kërkuar : **Gullash gjedhi me patate min. 330gr, paketimi në qese shumë shtresore e mbyllur me foli mbrojtëse sipas standardeve**, ndërsa të përshkrimi i artikujve ka kërkuar që gullashi të jete në ketë përbërje:: **Copa mishi (33%), patate te skuqura, qep, speca, borzilok, hudhër, vaj, biber.**

Pjesa I- Ushqim i Paketuar 5 - Në Aneksin nr. 1 të DT të artikulli në nr. 2 , AK ka kërkuar : **Gullash min. 300gr, paketimi ne qese shumë shtresore e mbyllur me foli mbrojtëse sipas standardeve**, ndërsa të përshkrimi i artikujve ka kërkuar që gullashi të jete në ketë përbërje: **Copa mishi (33%) lëng mishi, qep, pluhur orizi, pluhur misri, vaj speca, borzilok dhe hudhër, biber.**

Pjesa J- Ushqim i Paketuar 6 - Në Aneksin nr. 1 të DT të artikulli në nr. 2 , AK ka kërkuar: **Mish pule me kërpudha min. 300 gr paketimi ne qese shumë shtresore e mbyllur me foli mbrojtëse sipas standardeve**, ndërsa të përshkrimi i artikujve ka kërkuar që gullashi të jete në ketë përbërje: **Copa mishi te pulës (33%), kërpudha (6%) lëng mishi pulës, krem, vaj, miell orizi, gjalpë, miell misri, krip.**

Kërkesa e këtyre katër artikujve të Ushqimeve të paketuara ,(3,4,5,6) që AK ka shënuar në Aneksi Nr. 1 i Dosjes së Tenderit dhe Lista e artikujve - Përshkrimi i Çmimeve është bere vetëm sa për të ju pa mundësuar OE që të ofertojnë në ketë aktivitet të prokurimit. Shume qarte shihet së AK ketë specifikim teknik ja ka përshtatur vetëm një prodhuesi që asnjëherë deri tani nuk e ka tregtuar këto katër produkte në tregun e Kosovës e të cilët nuk prodhohen e tregtohen as në regjionin e Ballkanit e me shume vështirësi gjinden në tregun e Evropian dhe pikërisht për këta katër artikuj ka kërkuar Autorizim për shitjen e tyre. Për shkak të sasisë së vogël të këtyre artikujve, dhe përshtatjes se specifikimeve teknike per nje prodhues te caktuar, kompanitë Evropiane hezitojnë që të autorizojnë kompani në tregun e Kosovës dhe ti prodhojnë këta artikuj me specifika të cilat i ka kërkuar AK.

Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP –së që Ankesën tone ta konsideroje si të bazuar dhe me qellim të eliminimit të të gjitha lëshimeve, diskriminimit dhe spekulimeve që Autoriteti Kontraktues ka bere gjate hartimit të Dosjes së Tenderit, Përshkrimit të Çmimeve - Artikujve dhe Njoftimit për Kontrate dhe me qellim të dhënies së mundësisë të një numri sa me të madhe të OE që të ofertojnë në ketë aktivitet të prokurimit të urdhëroje AK- Akademia e Kosovës për Siguri Publike që ti ndërmarre këto veprime:

1. **Të hiqet kërkesa diskriminuese nga Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për Kontrate - Përshtatshmëria profesionale - 8. Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr. 3,4,5,6.**

2. **Të hartoj Aneksin e Specifikimeve Teknike dhe Përshkrimin e Çmimeve sipas llojeve të ushqimeve (menyve) në racionin e mëngjesit, drekës dhe darkës, ashtu siç veprojnë të gjitha Autoritetet Kontraktues në Republikën e Kosovës kur zhvillojnë këtë lloj të aktiviteti të prokurimit.**

3. **Të hiqen nga Aneksi nr. 1 e DT dhe Lista e Artikujve – Përshkrimi i Çmimeve, artikujt për ushqimet e paketuar në numrin 3,4,5 dhe 6 , të cilët AK - Akademia e Kosovës për Siguri Publike për 23 vite, asnjë here nuk i ka kërkuar këta lloj të artikujve në Dosje të Tenderit, Specifikimin Teknik dhe Përshkrimin e Çmimeve.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Aneksit 5- Kërkesë për Informacione shtese, shpenzimet Kërkesës për Rishqyrtim dhe shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftim për kontrate: 24.11.2023
2. Aneksi 5- Kërkesë për Informacione shtese: 04.12.2023
3. Informacione shtesë të publikuara nga AK në platformën e e-Prokurimit me datën 07.12.2023;
4. Kërkesë për Ri-shqyrtim: 07.12.2023
5. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim: 08.12.2023;
6. Formulari B54- Njoftim për Informata Shtese ose Përmirësim i Gabimit- 11.12.2023
7. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 te LPP-së;

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

NJOFTIM PËR KONTRATË

Retender

☐ *PUNË* ☐ *FURNIZIM* ☒ *SHËRBIME*

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 23.11.2023

Nr i Prokurimit	214-23-13065-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE		
Adresa Postare: "GJ.K.SKENDERBEU P.N."		
Qyteti: **VUSHTRRI**	**Kodi postar: 42000**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: Bekim Dakaj	Telefoni: **028/590-070 -Lok.280**	
Email: **bekim.dakaj@rks-gov.net**	Faksi:	
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*:		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Shërbimet e përgaditjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së -Ritender

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☐ **Punë**	☐ **Furnizime**	☒ **Shërbime**
☐ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Akademia e Kosovës për Siguri Publike - Vushtrri

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☒

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☒

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☒

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 36

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Shërbimet e përgaditjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së ritender ka për qëllim kryerjen e shërbimeve ushqimore në kuzhinen e AKSP për të gjithë pjesëmarrsit që vinë në

trajnime si nga Policia e Kosoves,Shërbimi Korrektue,Shërbimi Sprovues,Dogana,Fakulteti i Sigurisë

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

15894210-6

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ Jo ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (*nëse aplikohen)*

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 1,608,300.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
Për më shumë informata referoju dosjes së tenderit

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10% % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u

jepet kontrata *(nëse aplikohet)*:
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës **Po** ☐ **Jo** ☒ *Nëse po,* përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04 L-237, Ligjin Nr. 05 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.	1.Deklaratë nën betim -duhet tëdorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik
2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.	2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës.
3.Vërtetimin nga Gjykata themelore - Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor"apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dështmohet për Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD) të dosjes se tenderit te Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4.	3.Vërtetimin nga Gjykata themelore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës origjinal kopje e noterizuar.
4.Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme ne gjashte mujorin e fundit nga njoftimi per kontrate.	4.Vërtetim nga Gjykata Themelore – origjinal ose kopje e noterizuar.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
5.Certifikata e regjistrimit të biznesit	5.Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit-Kopje.
6.Certifikata e regjistrimit të TVSH-së	6. Kopja e Certifikatës e TVSH-së
7.Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal	7. Certifikatë me numër fiskal (kopje).
8.Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr.3,4,5,6.	8.Autorizimi nga prodhuesi për shitjen apo dileri i autorizuar për shitjen e ushimit të paketuar me nr.3,4,5,6.,(origjinal ose koje e noterizuar).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
9.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se qarkullimi vjetor gjatë tre viteve te përfunduara	9.Vërtetim ose raportin ose raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin

2020,2021,2022 ka qenë në vlere jo me pak se 2,000.000 €	ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar, apo ATK dekleratat vjetore tri vitet e fundit. duhet te dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur. Vërejtje Operatori ekonomik që përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një apo dy vite do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale te përcaktuar ne dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 10. Operator Ekonomik duhet te dëshmoj minimumin e kapacitetin e fuqisë punëtore të kompanisë me të dhënat në vijim emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca(vite) dhe pozicioni në kompani minumi 15 punetor	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 10.Një pasqyrë tabelore e personelit Emrin, mbiemrin , mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca(vite) dhe pozicioni në kompani. duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.
11.OE duhet të dëshmoj stafin profesional min 4 kuzhinierë (4 nga kuzhinjert te jenë të kualifikuar Diploma ose qertifikata) ne fushën e gastronomisë.	11. Listën e stafit profesional e vulosur dhe nënshkruar nga OE, duke ofruar dëshmi për secilin kuzhinier . Kopjet e Diplomave ose qerifikatat për Kuzhinjer, kopja e kontratave të punës ose para kontrata.
12.Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit me profesion Kuzhinjer me Diplom , te cilet duhet të kenë përvojë pune minimumi 3 vjeçare,	12.Vendim me shkrim mbi caktimin e menaxherit te projektit (Kuzhinier te Diplomuar) i vulosur dhe nënshkruar nga OE.
13.Operatori ekonomik duhet të ofroj listën për kontratat në fushën e shërbimeve - gastronomisë, në rastë të konzerciumit lideri duhet të ketë kontrata të shërbimeve të përfunduara së paku 51% te vleres të shërbimeve te kerkuara (shërbime- përgatitje dhe servime te ushqimit), me institucione publike apo private minimum 1.600.000,00 euro. (Një milion e gjashtëqindmijë) para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	13. Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave në fushën e shërbimeve – gastronomis me rerefernca pozitive të përfunduara në vlerë min. 1.600.000,00 euro duke ju bashkangjitur listes se kontratave. Lista e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, Ne rast konzerciumi lideri duhet ti ketë në emër të OE referencat me vler 51% të totalit për tri vitet e fundit të dëshmuara me referenca të suksesshme të përfunduara para njoftimit për kontratë, në kopje në rast konzerciumi të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet përkatëse , për shërbimet e pranuara , cilat duhet të tregojnë numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve. a. Kur shërbimimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë. b. Kur shërbimimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga blerësi i tille. Vërejtje Asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e shërbimeve ose raportet e pranimeve të shërbimeve me transfere

	bankare.
14. OE duhet te ofroj dëshmi •Automjet i mbyllur min 2 cope.në emer të OE •Pajisjet e nevojshme për ruajtje dhe transport të ushqimit në teren (termoset) minimum 6 copë për ushqime.	14. Lista e mjeteve Dëshmitë •Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit, njeri nga automjeti te jetë frigo në emer të OE - kopje •Fotografit me përshkrim te pajisjeve për bartjen e ushqimit- kopje
15.Certifikata ISO 9001 -2015(Sistemi i menaxhimit te cilesis), si dhe certifikaten ISO 22000-2018 (sistemet e menaxhimit te siguris ushqimore).	15.Certifikata ISO 9001-2015 , si dhe certifikaten ISO 22000-2018 në origjinal apo kopje të noterizuar me afat validiteti.
16.Katalog ose broshurë për produktet e ushqimit të paketuar me nr. 3,4,5,6.	16.Katalog ose broshur i cili duhet të përputhet me specifikacionin teknik te pakove me nr. 3,4,5,6 konkretisht te nr. rendor nr. 2.

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ **Jo** ☒

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☐ **Jo** ☒

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ **Jo** ☐
IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është:
IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒ Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

ose

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë **Po** ☒ **Jo** ☐ ***Nëse po,*** Njoftim paraprak: i Publikime tjera (*nëse aplikohen):* i **10.01.2023** i
Po ☐ **Jo** ☒ Dokumentet me pages ***Nëse po,*** çmimi EUR Kushtet dhe metoda e pagesës:
IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:* ***data*** **13.12.2023** ***koha*** **14:00:00** ***vendi*** AKSP, Vushtrri
IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar: ☒ **Po** ☐ **Jo** ***Nëse po,*** jep arsyetim A r s y e t i m **Bazuar ne faktin se aktiviteti i paraparë ne planin e prokurimit për Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimin me ushqim për nevojat e AKSP-se njoftimi për kontratë është shpall me 10 janar 2023 dhe pas shpalljes kemi pasur ankesë nga OE ne OSHP dhe aktiviteti është pezulluar deri ne zgjedhjen e ankesës. Për shak te pezullimit te aktivitetit ne kemi realizuar dy aktivitete emergjente për te shmangur ndërprerjen e trajnimeve ne Akademi. Me date 11 10 2023 OSHP ka nxjerr një Vendim me numër 2023 0503 ku len ne fuqi vendimin e AKSP për anulim te dhe Ri-shpallje te këtij aktiviteti dhe tani procesi është ne piken zero. Andaj duke u bazuar ne faktin se PK është ne fazën e rekrutimit te kadetëve te rinj për gjeneratën e 59 me 450 kadet, ne jemi te obliguar domosdoshmërish qe këtë aktivitet te shpallim me afate te**

përshpejtuara për te arritur kohen e fillimit te trajnimit profesional te kësaj gjenerate te PK-se. Po ashtu ne planin e trajnimit për fillim vit 2024 kemi edhe një gjeneratë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës qe edhe kjo ka ndikim te drejtpërdrejt ne funksionimin e AKSP-se dhe përmbushjen e misionit te saj për ofrimin e trajnimeve për Agjensionet e Sigurisë Publike.
IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit: **Po** ☒ **Jo** ☐ ***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit **20000 euro** Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** *apo* muaj
IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: Deri më: data: ditët **90** apo muajt
IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve: **data 13.12.2023 koha 14:00:00 vendi AKSP, Vushtrri- Dorezimi ne menyre elektronike ne Eprokurim**

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHTESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. *Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*

Pytje nga O.E.:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit:

Për ta përgatiture ofertën tone ne mënyre profesionale, paraprakisht kërkojmë nga AK- AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE, që të na përgjigjet në pyetjet e poshtëshënuara dhe ti beje korrigjimet e nevojshme bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Konsiderojmë së ju si Autoritet Kontraktues, Dosjen e Tenderit – Aneksin nr. 1- Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Përshkrimin e Çmimeve- Specifikacioni për Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimin me ushqim për nevojat e AKSP-se, dhe Kërkesën e Përshtatshmërisë Profesionale 7.1&7.2—8- **Autorizim nga prodhuesi ose Dileri i autorizuar për shitje për ushqimin e paketuar me nr.3,4,5,6** , e keni hartuar dhe kërkuar në kundërshtim të plote me legjislacionin primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Pse në konsiderojmë kështu:

Pjesa A- Mëngjesi – për të gjithë artikujt prej nr. **1** deri nr. **21** keni kërkuar sasinë **12145 cope.**

Pyetja 1:

Si ka mundësi që për artikullin me **nr.1 – Bukë 150 gr.** të kërkohen **12145** cope, e në anën tjetër për të gjithë artikujt tjerë që përbejnë së paku **10** lloje të racioneve (menyve), **të kërkohen nga 12145 cope** **për çdo artikull.** Sipas kësaj që keni shënuar ju, del që çdo person për çdo racion të mëngjesit i konsumon të gjithë **21** artikujt që janë të shënuar në Aneksin 1 të DT dhe Përshkrimin e Çmimeve. Nëse këto të dhëna mbesin ashtu siç i keni shënuar ju, lëne mundësin e manipulimit të çmimeve gjate ofertimit dhe pastaj edhe gjate fazës se realizimit te kontratës.

Pyetja 2: Artikulli nr. 2- Kifle me gjemë ose me euro krem-

Sa duhet me qene peshe e kifles?

Pyetja 3: Artikulli nr. 3- Byrek me djathë ose me mish

Sa duhet me qene peshe e burekut?

Pjesa B- Dreka – për të gjithë artikujt prej nr. **1** deri nr. **26** keni kërkuar sasinë **16890**

cope.

Pyetja 4:

Si ka mundësi që për artikullin me **nr.1 – Bukë 200 gr.** të kërkohen vetëm **16890 cope**, e në anën tjetër për të gjithë artikujt tjerë që përbejnë së paku **20 lloje** të racioneve (menyve), të kërkohen nga **16890 cope** për çdo artikull. Sipas kësaj që keni shënuar ju, del që çdo person për çdo racion të drekës i konsumon të gjithë **26** artikujt që janë të shënuar në Aneksin 1 të DT dhe Përshkrimin e Çmimeve. Nëse këto të dhëna mbesin ashtu siç i keni shënuar ju, lëne mundësin e manipulimit të çmimeve gjate ofertimit dhe pastaj edhe gjate fazës se realizimit te kontratës.

Pyetja 5: **Artikulli nr. 6-** Pije te gazuara 330 ml- Lëngje pemëve dhe frutave, pije te gazuara 330 ml. njëra nga to.

Përveç pijeve të gazuar keni përfshi edhe Lëngje pemëve dhe frutave të cilat nuk gjinden ne treg ne paketim prej 330 ml.

Cila nga keto duhet te jete a Pije te gazuara 330 ml a Lëngje pemëve dhe frutave

Pjesa C- Darka – për të gjithë artikujt prej nr. **1** deri nr. **20** keni kërkuar sasinë **12145 cope.**

Pyetja 6:

Si ka mundësi që për artikullin me **nr.1 – Bukë 200 gr.** të kërkohen **12145 cope**, e në anën tjetër për të gjithë artikujt tjerë që përbejnë së paku **17 lloje** të racioneve (menyve), të kërkohen nga **12145 cope** për çdo artikull. Sipas kësaj që keni shënuar ju, del që çdo person për çdo racion të darkës i konsumon të gjithë **20** artikujt që janë të shënuar në Aneksin 1 të DT dhe Përshkrimin e Çmimeve. Nëse këto të dhëna mbesin ashtu siç i keni shënuar ju, lëne mundësin e manipulimit të çmimeve gjate ofertimit dhe pastaj edhe gjate fazës se realizimit te kontratës.

Pjesa E- Ushqim i Paketuar 1- të kolona- Përshkrimi i artikujve, në artikullin nr.2- keni shënuar: Pashtet pule konservë 95gr, 2 copë

Në kolonën e njësisë keni shënuar copë dhe në kolonën e sasisë keni shënuar **2400**. Sipas kësaj që keni shënuar, konsiderojmë së është dashur që sasia e pastetave të jete **4800** ose të hiqet nga përshkrimi i **artikullit 2 cope.**

Pyetja 7:

Sa duhet të jete sasia për artikullin nr. 2 - **Pashtetë pule konservë 95gr, 2400** cope apo **4800** cope?

